



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.81

Prishtinë, më 22.2.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi, Bekim Haxhiu dhe Mufera Shinik

Mungoi: Sërgjan Popović

Përfaqësues të ftuar: Ministri i MASHT-it, Kryetari i Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe Ambasadori i Shqipërisë.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportim i Ministrisë lidhur me gjendjen në Arsimin e Lartë;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Raportim i Ministrisë lidhur me gjendjen në Arsimin e Lartë

Kryetari i Komisionit, Nait Hasani, fillimisht tha se arsimi po has në vështirësi dhe nuk është në nivelin e duhur, kjo pasqyrohet edhe përmes rezultateve të PISA-së. Një problematikë tjetër është ajo e nostrifikimit të diplomave. Për sfidat, të arriturat si dhe çështje tjera me interes për fushën e arsimit, fjalën ia kaloi Ministrisë të MASHT-it, Arsim Bajramit.

Ministri Arsim Bajrami, tha se arsimi i lartë është pasqyrim i realitetit që po kalojmë, por që në dy vitet e fundit kemi bërë përparim, i cili është i paraqitur edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën në vitin që lëmë pas. Ai veçoi tri fusha në të cilat si Ministri janë fokusuar sa i përket arsimit të lartë dhe ato janë: ligjshmëria e bartësve publikë dhe atyre privatë, ajo për standardet e cilësisë si dhe e treta, orientimi i arsimit të lartë në përshtatjen me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Sa i përket arsimit publik, Bajrami tha se kemi shtatë universitete publike dhe se gjatë dy viteve të fundit kemi zhvilluar një proces të konsolidimit të universiteteve të reja, në të cilat janë zgjedhur të gjitha organet e universiteteve dhe tash ato janë funksionale.

Ai shtoi se tek të gjitha universitetet publike është vendosur standardi i munguar deri më tani, ai i meritës në pranim dhe tani ky standard vlen për të gjitha nivelet e studimeve. Në vazhdim të fjalës së tij, tha se sa i përket segmentit të tretë, ai ka takuar të gjithë rektorët e universiteteve publike dhe janë pajtuar që programet e tyre t'i orientojnë kah nevojat e tregut të punës. Ai përmendi suksesin e arritur së bashku me Komisionin për Arsim, për sa i përket themelimit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara, që është i modelit gjerman dhe se ky model do të aplikohet edhe tek Universiteti i Pejës, Mitrovicës dhe Gjilanit, ndërsa Universiteti i Prishtinës duhet të specializohet në programet për të cilat ka nevojë.

Cilësia e mësimdhënies vazhdon të mbetet sfidë dhe se duhet të rrisin kompetencat dhe shkathhtësitë e studentëve dhe se kjo është një kërkesë e MASHT-it, që Universitetet të krijojnë mekanizma të brendshëm për vlerësimin e cilësisë. Ndërkaq, ai përmendi tre mekanizmat e jashtëm që bëjnë vlerësimin e cilësisë, atë të Agjencisë të Akreditimit, të Inspektorati si dhe ajo e Qendrës Kombëtare për Cilësi.

Bajrami tha se mund të konstatojmë se gjendja në arsimin e lartë është drejt përmirësimit dhe se ata janë të përkushtuar për të respektuar autonominë e universiteteve dhe se janë të përkushtuar në rritjen e cilësisë dhe kredibilitetit të diplomave.

Ai njoftoi Komisionin se së shpejti do të fillojnë me pilotimin e testeve për profesionet e rregulluara dhe se ky do të jetë një mekanizëm që do të tregojë cilësinë e vërtetë të diplomave që lëshojnë universitetet.

Tek sektori privat, ministri Arsim Bajrami, tha se është shënuar progres i konsiderueshëm. Tani nuk kemi asnjë kolegji që quhet Universitet dhe si Ministri kemi rritur kontrollin sa i përket programeve të tyre

Në vazhdim të fjalës së tij, ai shtoi se është bërë një përparim simbolik sa i përket cilësisë së Universitetit të Prishtinës, i cili ka shënuar ngritje në ranglistë, por që tha se ngritje të cilësisë kanë shënuar edhe disa bartës të arsimit privat.

Ai foli edhe për bashkëpunimin ndërkombëtar, për të cilin tha se ka shtim të partneriteteve dhe theksoi ato që kanë me Qeverinë e Britanisë, atë Hungareze si dhe me Qeverinë Amerikane sa i përket skemës së FullBright. Sa i përket brengës së nostrifikimit të diplomave, ai tha se pas marrëveshjes ndërshtetërore me Shqipërinë, kanë filluar me pranimin e aplikacioneve për njohjen e diplomave të atyre që kanë përfunduar studimet në sektorin privat në Shqipëri.

Në lidhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, ministri Bajrami tha se ky ligj është shumë i rëndësishëm dhe i cili është diskutuar në secilin universitet publik dhe kolegji privat, tha se ky ligj sipas Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit, kërkon 2/3 e dyfishta për t'u miratuar. Ky ligj, për herë të parë përfshin edhe Universitetin Publik të veriut të Mitrovicës brenda ligjit dhe juridiksionit të Kosovës. Ndërkaq, sa i përket arsyes pse ligji nuk është proceduar është logjike. Ai njoftoi anëtarët e Komisionit për letrën që i ka dërguar kryetarit të Kuvendit që në seancën e parë në të cilën do të jetë e pranishme Lista Serbe dhe do të ketë kuorum, ai ligj të diskutohet dhe si i tillë të miratohet.

Një çështje tjetër e diskutuar ishte ajo për programet e paakredituara në Fakultetin e Edukimit. Ai tha se kjo ka ndodhur para kohës që ai të marrë drejtimin e MASHT-it dhe se në atë kohë janë zhvilluar programe të paakredituara, ndërkaq sa i përket zgjidhjes së kësaj, ai tha se do të bëjmë zgjidhje ligjore.

Në fund të fjalës së tij, ministri Bajrami tha se mund të konkludojmë që gjendja në arsimin e lartë ka trend pozitiv, MASHT-i në plotni e respekton autonominë akademike dhe financiare të universiteteve, arsimi i lartë po orientohet në fushat që Kosova ka nevojë.

Blerim Rexhaj, në paraqitjen e tij tha se agjencia që ai drejton vazhdon të respektojë udhëzimin administrativ i cili rregullon fushën e arsimit të lartë dhe kjo ka rezultuar në zvogëlimin e numrit të programeve të studimit. Ai tha se në vitin e kaluar, kanë heq 71 programe të studimit si dhe kanë refuzuar 19 programe, të cilat nuk kanë përmbushur kriteret për akreditim, ndërsa 6 institucione iu është ndaluar të regjistrojnë studentë të rinj në këtë vit akademik.

Ai siguroi anëtarët e Komisionit që janë të përkushtuar në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë si dhe zbatimin e udhëzimit administrativ në fuqi. Një sfidë më të cilën ende ballafaqohen si Agjenci, sipas tij, është rritja e transparencës. Ai tha se sa i përket akreditimit të programeve, janë shqyrtuar vetëm ato që kanë qenë në një proces të tillë, por që i kanë njoftuar institucionet relevante që edhe këto programe pavarësisht që janë në proces akreditimi, nuk mund të akreditohen nëse nuk i plotësojnë kriteret minimale. Ai tha se progresi i shënuar nga Agjencia që ai udhëheq, është i përfshirë edhe në Raportin e Progresit dhe shtoi se janë të përkushtuar që të harmonizojnë kurrikulat me nevojat e tregut të punës.

Nait Hasani, ngriti shqetësimin e tij në lidhje me ankesën e studentëve që kanë kërkuar regjistrimin në vitin 2011-2013, në një program në Universitetin e Prizrenit dhe pasi që ia përkujtoi ministrit fjalën e tij për zgjidhje ligjore, ai deshi të dijë se cila është ajo zgjidhje.

Ai theksoi se Ligji për Arsimin e Lartë, ka kohë të gjatë që është tërhequr për arsye të sigurimit të votimit me 2/3 të votave të pakicës serbe dhe është mirë që të gjendet një formë e përfshirjes së këtij ligji në një paketë më ligje tjera dhe pyeti ministrin se a do të kemi një ligj të vetëm dhe gjithëpërfshirës që të shërbejë si bazë për Arsimin e Lartë dhe një i tillë të mos ndërrohet sa herë të vijë ministra të rinj. Ai shtoi se janë duke punuar në Projektligjin e Inspektoratit dhe nga

debatet më përfaqësuesit e DKA-ve të rajonit të Gjilanit si dhe në debatin në komision, po kërkohet që të rritet numri i inspektorëve.

Salih Morina tha se rekomandimet e dala pas interpelancës së Ministrisë të MASHT, janë të mirëseardhura dhe se rekomandimi që ministri të raportojë çdo tre muaj para Komisionit, është i duhur duke parë sfidat dhe vështirësitë që po kalon fusha e arsimit. Ai shtroi pyetjen se a ka fakultete që zhvillojnë mësimin me programe të paakredituara, qoftë në sektorin publik edhe në atë privat. Një pyetje tjetër e parashtruar nga Morina, pati të bënte me nostrifikimin e diplomave mes Kosovës dhe Shqipërisë, se a ka ndonjë afat se kur do të përfundojë ky proces. Ai tha se do të ishte me interes edhe për publikun që të dijë se cilët janë kolegjet të cilat janë mbyllur.

Një tjetër çështje me interes për Morinën, ishte edhe respektimi i kriterëve të pranimit të studentëve të rinj, pasi që sipas tij gjatë periudhës 2015, thuhet që ka pasur shkelje të tilla të kriterëve të konkursit, andaj shprehi interesimin të dijë se a ka ndodhur e njëjta edhe në vitin vijues.

Ismajl Kurteshi në fjalën e tij theksoi se pavarësisht asaj që prezantuan të ftuarit para Komisionit se sektori privat ka shënuar përparime të theksuara dhe se kjo ka ardhur si rezultat i shtimit të kontrollit të programeve të tyre, ai kontestoi këtë dhe tha se rezultatet për cilësi më të mirë nuk po shihen në terren. Sa i përket promovimit të standardit të cilësisë në pranimin e studentëve të rinj, ai tha se një gjë e tillë nuk po respektohet dhe se dëshmi për këtë janë listat e studentëve të pranuar në fakultete të ndryshme.

Një shqetësim tjetër i paraqitur nga Kurteshi ishte edhe ai se fakultetet po hapin programe të paakredituara. Ai pati një shqetësim për angazhimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Akreditimit në kolegjet private si ligjërues dhe se një gjë e tillë po e cenon paanshmërinë dhe vlerësimin e drejtë të programeve të këtyre kolegjeve.

Në vijim, Kurteshi tha se janë 178 profesorë të cilët punojnë me diploma të panostrifikuara, 56 profesorë janë të angazhuar në mësimdhënie dhe nuk kanë fare diploma, edhe angazhimi i asistentëve në mbajtjen e ligjëratave është shkelje e ligjit, si dhe angazhimi i profesorëve pa konkurs. Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, mbi 50% e stafit duhet të jetë në marrëdhënie pune për t'u hapur një institucion i Arsimit të Lartë, por që shumë prej tyre nuk e përmbushin këtë kriter. Ai pati shqetësimin edhe sa i përket përbërjes së Komisionit për Nostrifikimin e Diplomave, i cili nuk është i kompletuar dhe se mungojnë dy anëtarë dhe se kjo gjendje vazhdon të jetë për një kohë të gjatë.

Shqetësim tjetër ishte edhe mosrespektimi i afateve për regjistrim të studentëve nga ana e kolegjeve private dhe shtoi se Ministria me këtë rast duhet të ndërmarrë masa konform ligjit dhe të mos mbetet vetëm si vëzhgues i gjithë kësaj. Më tej ai shtoi se, shumë universitete po hapin programe të reja për nevoja të profesorëve, por që nuk kanë nevojë për tregun e punës. Ai kërkoi që të rishqyrtohet roli i Fakultetit të Edukimit, si kusht për t'u kualifikuar për mësimdhënës e që sipas tij kjo është një zgjidhje e papranueshme.

Në fjalën e tij, Kurteshi paraqiti edhe të gjeturat e hulumtimit të Organizatës për ngritjen e cilësisë në arsim, sipas të cilat raport, CV-ja e pesë anëtarëve të Këshillit Drejtues të UP-së, të cilët nuk i justifikojnë titujt e tyre. Gjashtë anëtarë të Rektoratit, tre prej tyre nuk i justifikojnë titujt e tyre, nga dymbëdhjetë dekanë, pesë prej tyre nuk i justifikojnë titujt e tyre, nga tetë

senatorët e deleguar, pesë prej tyre nuk i justifikojnë titujt e tyre, nga njëzetën një senatorë, nëntë prej tyre nuk i justifikojnë titujt e tyre, nga njëzetën një prodekanë, dymbëdhjetë nuk i justifikojnë titujt e tyre, nga tetëmbëdhjetë profesorë të rregullt, njëmbëdhjetë nuk i justifikojnë titujt e tyre, nga njëzetë profesorë të asocuar, dymbëdhjetë nuk i justifikojnë titujt e tyre, shtatë profesorë asistentë nuk i justifikojnë titujt e tyre.

Më tej, ai foli edhe për normën e angazhimit të stafit akademik. Ai theksoi vendimin e UP-së, ku në pikën 3 thuhet se: stafi Akademik në Marrëdhënie të rregullt pune sipas nevojës për angazhim shtesë mund të angazhohet edhe për një normë të plotë mësimore. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për Konflikt Interesi, ku ligji parasheh një normë të plotë dhe 50% shtesë.

Një shqetësim tjetër është edhe mospranimi i katër studentëve nga Gjilani, të cilave u është bërë e padrejtë dhe u është mohuar e drejta e regjistrimit në nivelin Master në Fakultetin Ekonomik, dhe se kjo ka ndodhur pavarësisht që ato kanë kaluar provimin pranues dhe shtoi se kjo nuk arsyeton zotimin për promovimin e standardit të cilësisë.

Kurtshi pati vërejtje sa i përket hapjes së paraleleve në shkollat e mesme në Komunën e Gjilanit, ku kjo bëhet me një muaj e gjysmë vonesë. Ai shtoi se para pak ditësh është mbyllur shkolla e mesme e bujqësisë dhe se nxënësit janë bartur në shkollën teknike dhe kjo ka shkaktuar çrregullim orari dhe se tani orët e mësimit janë shkurtuar në tridhjetë minuta. Sipas tij, MASHT-i duhet të ndërmarrë veprime sepse kështu po dëmtohet cilësia dhe arsimimi.

Mufera Shinik kërkoi sqarim lidhur me studentët të cilët kanë përfunduar studimet në Universitetin e Prizrenit, me ç'rast në disa fusha specifike, nuk po u njihen diplomat jashtë vendit dhe se ata nuk po mund as të regjistrohen në nivelin master. Shqetësimi tjetër ishte përbërja e Agjencisë së Akreditimit në të cilën nuk ka asnjë përfaqësues të komuniteteve anipse punojnë me kurrikulat e Republikës së Kosovës si dhe pyetja pati të bëjë më problemin e nostrifikimit të diplomave dhe më këtë rast ajo kërkoi të dijë se cila është zgjidhja për këtë problem.

Teuta Haxhiu ngriti çështjen e përgjegjësisë për gjendjen në Arsimin e Lartë, duke theksuar se cilësia nuk mund të arrihet duke hedhur fajin njëri tek tjetri dhe pyeti ministrin se a do ta bëjë edhe ai të njëjtën gjë pas përfundimit të mandatit të tij. Sa i përket cilësisë së sjellë nga Agjencia e Akreditimit, ajo tha se gjendja nuk ka ndryshuar shumë që nga ardhja e udhëheqjes së re të këtij institucioni dhe se cilësia është ende larg për t'u arritur. Më tej, ajo shtoi se kolegjet private janë shndërruar në biznese dhe po krijojnë mundësi të mëdha të korrupsionit. Por, duhet theksuar se ajo është për atë që të kemi institucione private të arsimit të cilat do të ishin në garë sipas vlerave dhe cilësisë më ato publike. Mirëpo, ajo tha se i favorizon universitetet publike për shkak të më shumë së një arsye, pasi që sipas saj, kjo është në interes të studentit, prindit që të kryejnë shkollimin në universitete publike, për shkak të financave, kredibilitetit etj.

Ajo përmendi vendimet e Agjencisë për mbylljen e disa kolegjeve private, atij Universum në Gjakovë, të Biznesit në Vushtrri, por që mbyllja e tyre ka zgjatuar vetëm për dy ditë dhe tani diplomat e tyre janë të kontestuara.

Më tej, ajo shtoi se shumë prej këtyre kolegjeve nuk i plotësojnë as kriteret minimale, si me staf, hapësirë dhe kushte që të zhvillojnë mësim dhe si rrjedhojë kjo minimizon arritjen e cilësisë. Haxhiu kërkoi që urgjentisht të mbyllen kolegjet që nuk i plotësojnë kriteret e akreditimit, duke theksuar se kjo po mundëson korrupsionin dhe se gjithërë pas këtyre po qëndron politika Ajo përmendi Udhëzimin Administrativ, për rregullimin e normës për mësimdhënësit e cila nuk lejon

asnje nga bartësit e Arsimit të Lartë, nuk nxjerr mësimdhënës. Ky vendim ka krijuar amulli dhe se një numër i konsiderueshëm i diplomave ua kanë zënë vendin atyre që kanë kryer studimet në bartësit e arsimit publik. Ky Udhëzim Administrativ, po keqpërdoret nga Komunitat dhe ajo tërhoqi vërejtjen që ligji nuk mund të respektohet në mënyrë retroaktive.

Shukrije Bytyçi tha se është e pakuptimtë që cilësia të kërkohej vetëm nga rektorët e universiteteve dhe shtoi se nuk pajtohet që universitetet të kenë autonomi edhe atëherë kur ato shkelin ligjin. Të gjitha universitetet, përveç atij të Prishtinës, janë themeluar për arsye politike dhe se problemet e arsimit janë që nga koha e paraluftës. Ajo shtoi se mësimdhënësit po pranohen jo mbi bazën e meritokracisë. Bytyçi paraqiti shqetësimin e saj sa i përket çështjet e biologëve, drejtimi biokimi në nivelin bachelor, program ky i akredituar ku studentët i kanë përfunduar studimet, por që nuk kanë të drejtë pune askund, dhe për këtë rreth njëqind studentë nuk kanë marrë ende përgjigje. Sipas saj, është bërë një ndasi për këta studentë, ku ata që kanë kryer nivelin e studimeve master iu është dhënë mundësia që t'i ndjekin disa module në Fakultetin e Mjekësisë dhe kanë marrë licencë kurse ata tjerët që nuk kanë licencë punojnë në laboratorë të ndryshëm dhe janë të regjistruar si punëtor teknik apo mirëmbajtës dhe ajo në këtë pikë kritikoi edhe Inspektoratin Shëndetësor për mospunën e tij. Më tej tha se mosakreditimi i programit në Universitetin e Prizrenit është shqetësues dhe se nuk është e natyrshme që kjo çështje të zgjidhet me zgjidhje ligjore përderisa është Agjencia e Akreditimit.

Çështje tjetër ishte lidhur me studentët që kanë kryer studimet në Universitetin Kristal dhe që kanë marrë licencë por që nuk e kanë diplomën e nostrifikuar, shqetësim tjetër ishte edhe Fakulteti i Edukimit, që sipas saj është shndërruar në eksperiment jo i analizuar mirë dhe ku studentët po detyrohen të kryejnë një master në këtë fakultet, përderisa ky fakultet nuk i përmbush kushtet për një gjë të tillë. Ajo shtoi se studentët që po përfundojnë këtë master në fund të studimeve të tyre, nuk po kanë mentor, dhe se do të ishte mirë që ky fakultet të merret vetëm me ciklin e ulët, parashkollor dhe atë shkollor.

Një çështje tjetër e ngritur ishte se deri ku kanë shkuar procedurat për Fakultetin e Shkencave, pasi që ky fakultet nuk qëndron mirë sa i përket kushteve për mbarëvajtjen e mësimin, dhe si rrjedhojë ata studentë duhet të zhvillojnë mësimin në ambiente jo të përshtatshme për mësim. Krejt në fund të fjalës së saj, ajo tha se shqetësimi me diplomat false, kanë shkaktuar problem si me studentët që i kanë marrë këto diploma po ashtu edhe me institucionet që i kanë lëshuar ato, dhe ajo dëshironte të dijë se deri ku ka shkuar procesi i zgjidhjes së këtij problemi.

Bekim Haxhiu në fillim të fjalës së tij prezantoi kërkesën e profesorëve të Fakultetit të Mjekësisë për themelimin e Universitetit të Shkencave të Mjekësisë, duke shtuar se kjo kërkesë mbështetet nga 95% e stafit akademik të këtij fakulteti. Ai tha se një veprim i tillë do të ngriste cilësinë në këtë fakultet dhe se një model të tillë të funksionimit të Universitetit të Shkencave të Mjekësisë e kanë edhe shumë vende të Evropës.

Në vazhdim, ai rikujtoi që MASHT-i ka nënshkruar kontratë me Sindikatën e Punëtorëve të Arsimit, kontratë kjo që në praktikë nuk po respektohet, sidomos tek kontratat e përhershme të cilat më pastaj po ndryshohen në kontrata më afat të caktuar. Ai tha se kjo po ndodh në arsimin parafillor, fillor dhe se Udhëzimi Administrativ i ka dhënë efekt retroaktiv disa nga DKA-të dhe kjo përbën shkelje të të drejtave të punëtorëve dhe shkelje ligjore dhe për këto duhet të reagojë Inspektorati Arsimor.

Sa i përket ngritjes së cilësisë, ai tha se nuk është shumë i inkurajuar më këtë rritje dhe e quajti rritje simbolike. Ai shtoi se për të pasur ngritje të cilësisë, duhet të investohet më shumë në shkencë dhe inovacion dhe kërkoi nga ministri që të angazhohet edhe më shumë për këtë gjë pasi që jemi zotuar që 0,7% e buxhetit të vendit të shkojë për shkencë.

Në vazhdim, Haxhiu tha se Fakulteti i Edukimit ka krijuar monopol në programet e arsimit parauniversitar, fillor dhe parafillor dhe shtoi se me këtë Udhëzim Administrativ të MASHT-i, studentët që kryejnë studimet në Fakultetin e Mjekësisë, nuk kanë mundësi të japin mësim në Shkollën e Mesme të Mjekësisë dhe ftoi ministrin që ta rishikojë këtë UA.

Haxhiu tha se dëshiron të dijë se ku jemi me procedurat për digjitalizimin e provimit shtetëror të maturës dhe kur do të fillojë i njëjti të aplikohet edhe për profesionet e rregulluara, sepse sipas tij, do të ishte e kotë mbajtja e provimit të maturës nëse ai provim nuk do të digjitalizohet. Ai tha se një gjë e tillë do të mundësonte vlerësim ligjor të arsimit të lartë publik dhe privat.

Haxhiu tha se është mirë që të vendosen afate kohore për akreditimin e programeve dhe parashtrori pyetjen edhe për Ambasadorin e Shqipërisë, ku kërkoi që bashkëpunimi të jetë në rrafshin praktik dhe shtoi se duhet të angazhohemi në arritjen e nivelit të bashkëpunimit në programet e përbashkëta dhe të kemi orientim se për cilat programe kanë nevojë të dy shtetet dhe në këtë mënyrë të shmangim dublifikimin e programeve.

Ai po ashtu, paraqiti shqetësimin e kolegëve të tij nga Fakulteti i Mjekësisë, të cilët pas përfundimit të studimeve në Shqipëri, presin me vite për të marrë diplomën e tyre dhe se kjo po u shkakton probleme në punësim.

Shpejtim Bulliqi tha se gjendja e arsimit në vend nuk është edhe aq keq sa po paraqitet në opinion, por normalisht që ka vend për përmirësime. Ai tha se me ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë duhet të kihet parasysh edhe ngritja e cilësisë së nivelit parauniversitar dhe shtoi se nuk mund të presim përmirësim në ranglistën e PISA-s përderisa prodhojmë kuadro që nuk janë kompetent për të ushtruar veprimtarinë për të cilën kualifikohen. Ai po ashtu përmendi edhe vendimin e ish-ministrit Ramë Buja, për të cilin tha se e ka fundosur nivelin e arsimit universitar si dhe atë parauniversitar.

Ai njoftoi kryetarin e Agjencisë për Akreditim, se në një njësi akademike, ka program të akredituar i cili nxjerr profil arsimor për të punuar në arsimin parauniversitar, fillor dhe atë të mesëm të lartë, i cili program nuk ka asnjë doktor shkencë por ka vetëm asistent me titull master. Ai u shpreh i gatshëm të jap informacione shtesë dhe të bashkëpunojë në Agjencinë dhe po ashtu njoftoi të pranishmit se kjo njësi akademike i ka keqpërdorur CV-të e iks profesorëve dhe i ka fut në njësinë e vet akademike, duke akredituar program tjetër më këto CV-i dhe se po të njëjtat CV-i përdoren edhe për njësinë tjetër akademike, dhe po ashtu theksoi se nuk mund të presim rezultat nga studentët që dalin nga ky program i tillë. Ai tha se edhe CV-ja e tij është keqpërdorur pa dijeninë e tij, për qëllime akreditimi të programeve të caktuara.

Një shqetësim tjetër kishte të bënte më sistemin dy lëndorë, ku shtoi se në vend që mësimdhënësit të shkojnë të studentët, këta të fundit të cilët janë të interesuar të kryejnë mësimdhënien, në një formë obligohen të shkojnë tek profesori në Fakultetin e Edukimit. Ai tha se për këtë shkak ky fakultet nuk e ka asnjë kuadro meqë ata po ligjërojnë në kolegjet private, po bëjnë një përvojë dhe më pastaj po konkurrojnë në UP.

Ambasadori i Shqipërisë, Qemajl Minxhozi, foli për rëndësinë që fusha e arsimit ka për shoqërinë duke e konsideruar atë si hallka kryesore që shpie përpara zhvillimin e shoqërisë. Ai tha se bashkëpunimi efikas në fushën e arsimit duhet të thellohet dhe se dallimet që tani ekzistojnë duhet të mënjanohen sa më parë.

Minxhozi tha se ka probleme në rrafshin praktik të zbatimit të zotimit kombëtar për zhvillimin dhe thellimin e arsimit mes dy vendeve tona. Ai shtoi se nuk na bashkon vetëm gjuha e një abetare por duhet të na bashkojë edhe mentaliteti. Ambasadori kritikoi burokracitë që aplikohen për nostrifikim diplomash, leje pune si dhe leje qëndrimi që aplikohen për shtetasit shqiptar që vendosin të vijnë e punojnë në Kosovë dhe ai tha se një gjë e tillë nuk duhet të ndodh mes nesh. Në fund të fjalës se tij, Ambasadori tha se duhet të angazhohemi për harmonizimin e kurrikulave me nevojat e tregut të punës dhe në këtë mënyrë të shkëmbejmë mësimet dhe përparësitë krahasuese që kemi si dy vende.

Ministri Arsim Bajrami, në përmbledhjen e tij të përgjigjeve tha se ngritja e cilësisë është proces që zgjatë dhe se PISA na tregoi se ku jemi në këtë fushë, por që u shpreh optimist se në vlerësimin e ardhshëm të PISA-s, Kosova do të dal shumë më mirë pasi që, janë të përkushtuar dhe duke punuar në përgatitjen sa më të mirë të nxënësve edhe përmes simulimit që do të mbahet për këtë qëllim.

Ai tha se së shpejti do të themelohet Qendra Shtetërore e Testimit për të gjithë maurantët, mësimdhënien si dhe për ato profesione të rregulluara. Sipas tij, nuk ka asnjë program të paakredituar në universitetet publike as në kolegjet private. Sa i përket krijimit të monopolit në Fakultetin e Edukimit, ai tha se duhet të analizohet mirë dhe të shohim se a ka ky fakultet kapacitete për të përgatitur mësimdhënës, por këtë situatë të krijuar në këtë fakultet e arsyetoi duke thënë se ideja ka qenë përgatitja pedagogjike dhe metodike për mësimdhënës. Ai shtoi se duhet të stimulohen të gjitha kolegjet private që përmbushin kriteret dhe që ato më pastaj të shndërrohen në universitete.

Rreth bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë, Bajrami tha se janë bërë hapa pozitiv sa i përket njohës së diplomave por shtoi se ka ende burokraci që duhet të eliminohen. Ai tha se është pro që të kemi një diplomë më dy vula dhe në këtë mënyrë do të evitoheshin të gjitha procedurat e mundimshme me të cilat ballafaqohemi.

Blerim Rexha, po ashtu theksoi se nuk ka program që zhvillohet e që nuk është i akredituar. Ai shtoi se detyrë e institucionit që ai drejton është cilësia dhe shtoi se kemi mungesë të kuadrove. Ai tha se duhet të rritet kriteri bazë për akreditim, sa i përket numrit të tre doktor shkencave dhe shtoi se cilësia është tek kompetenca e profesorëve.

Rexha theksoi se kanë kërkuar që të publikohen të gjitha CV-të, lëndët, projektet etj, të të gjithë stafit akademik në mënyrë që të rrisim transparencën. Sa i përket akreditimit të programit në gjuhën turke, ai tha se kanë ndryshuar Udhëzimin Administrativ për të akomoduar programin në gjuhën turke, dhe në këtë mënyrë kemi krijuar bazë ligjore për të realizuar këtë program. Drejtimet deficitare, siç janë mamia dhe infermiera, ai tha se kemi pranuar që të fillojnë edhe pa tre doktor shkence, por që Institucioni duhet të ketë marrëveshje bashkëpunimi me një institucion prestigjioz dhe se duhet të sigurohet që brenda pesë viteve të ngritë kapacitetet e veta. Një program tjetër që është pranuar si i tillë, është edhe ai për shurdhmemec në Universitetin e Prizrenit.

3. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:35.

E përgatiti:

Stadi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani